Projekti: Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për qëndrueshmërinë financiare të organizatave qytetare

Mendo, planifiko, DHURO!

ДОНИРАЈ ПАМЕТНО



DONACIONI - ndihmë vullnetare dhe e pakushtëzuar në të holla dhe shërbime të cilat ofrohen për realizimin e qëllimeve me interes publik. *Dhuruesit (donatorët) nuk kanë dobi të drejtpërdrejt nga donacionet, ndërsa pranuesit e donacionit vlerën që u dhurohet nuk obligohen që ta kthejnë në asnjë mënyrë.*

FILANTROPIA (philoanthropos – „dashuria ndaj njerëzimit“) – i nënkupton format e ndryshme të dhurimit vullnetar të mjeteve personale, kohës dhe mundit nga ana e një individi apo grupi, për shkak të zhvillimit të mirëqenies së njerëzve dhe arritjes së të mirave të përgjithshme.

BËHUNI EDHE JU FILANTROP!

Dhuroni mjete personale, kohë dhe mund për të mirën e njerëzve të tjerë dhe bashkësisë.

Krahas **dobisë për shoqërinë**, mbështetjen që e jepni ju sjell dobi juve dhe organizatës tuaj (kompanisë, industrisë, shoqatës etj.).

Para së gjithash, donacionet dhe sponsorimet e zhvillojnë **Reputacionin** dhe **imazhin** tuaj në shoqëri. Ligji për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike mundëson **stimulime tatimore**.

Ne do t'ju ndihmojmë ta realizoni këtë.

Tek ne:

- mbi **2/3** e qytetarëve kanë qëndrim pozitiv ndaj dhurimit
- mbi **80%** e qytetarëve dhurojnë, zakonisht për qëllime humanitare, në fushën e shëndetësisë dhe mbështetjen e personave me nevoja të veçanta, për të rinj dhe për fëmijë
- mbi **50%** e kompanive bëjnë donacione gjatë vitit
- Kompanitë kanë ndarë mbi **10 milionë e 500 mijë EURO** donacione dhe sponsorime në vitin 2013

Projektin e zbatojnë:

KONEKT

ECNL

Центар за даночна политика

Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

rr. „Vladimir Polezhinovski“ nr.19-1/6, 1000 Shkup
tel.: +389 (0)2 3224 198/ konekt@konekt.org.mk / ***www.konekt.org.mk***

SI TË FITOHEN BENEFICIONE TATIMORE?
gjatë donacionit

ME LIGJ MUNDËSOHET qytetarët (persona fizik) dhe kompanitë, shoqatat, institucionet dhe llojet e tjera të organizatave (persona juridik), të fitojnë një sërë **BENEFICIONESH TATIMORE** gjatë zbatimit të donacioneve dhe sponsorimeve në fusha me interes publik, siç janë: kultura, arsimi dhe shkenca , shëndetësia, sporti, mbrojtja sociale, mbrojtja e mjedisit jetësor, mbrojtja e të drejtave të njeriut, zhvillimi i shoqërisë civile, bashkëpunimi ndëretnik dhe ndërkombëtar, zhvillimi i shoqërisë informatike etj.

Çfarë BENEFICIONESH TATIMORE mund të fitoni?

- **Për qytetarët** (persona fizik) të cilët dhurojnë, ligji parasheh stimulime tatimore (beneficione) te **tatimi personal** i të ardhurave, nëse bëhet fjalë për donacione në të holla, te **donacionet e pronës**, për donacione në gjësende dhe të mira materiale, si dhe te tatimi i vlerës së shtuar (TVSH) gjatë donacioneve me telefon dhe bileta për ngjarje vullnetare.
- **Për kompanitë** (persona juridik) të cilët dhurojnë, ligji parasheh stimulime tatimore te **tatimi i fitimit** dhe **tatimi i vlerës së shtuar**, për donacione në mjete materiale dhe shërbime, si dhe te **donacionet e pronës** nëse bëhet fjalë për donacione në gjësende dhe të mira materiale.

  Mjetet e dhuruara lirohen nga TVSH-ja.

VËREJTJE! Beneficione tatimore mund të fitoni vetëm nëse u dhuroni personave juridik.

Cilat DOKUMENTE janë të nevojshme nëse dëshironi t'i shfrytëzoni beneficionet tatimore?

- **MARRËVESHJE** midis donatorit dhe shfrytëzuesit (*Nuk nevojitet marrëveshje nëse pranuesi i donacionit apo sponsorimit është shoqatë e qytetarëve apo fondacion i cili e ka statusin e organizatës me interes publik);
- **VENDIM** për përcaktimin e interesit publik të cilin e jep Ministria e Drejtësisë ;
- **VËRTETIM** për donacionin e pranuar nga pranuesi i donacionit;
- **RAPORT** për donacionin e dorëzuar-pranuar.

VËREJTJE! Procedura ligjore dhe dokumentacioni nuk nevojiten nëse vendosni të dhuroni, ndërsa më pas nuk dëshironi t'i shfrytëzoni beneficionet tatimore.

Vizitojeni ueb faqen e projektit "Dhuro me mençuri" në **WWW.DONIRAJPAMETNO.MK** ku do t'i gjeni të gjitha **informacionet** e nevojshme si dhe **formularët** për mënyrën dhe procedurën për fitimin e beneficioneve (stimulimeve) tatimore të cilat ju takojnë gjatë dhurimit apo sponsorimit të projekteve dhe aktiviteteve me interes publik.Ose na vizitoni në zyrën e **KONEKT** në rr. „Vladimir Polezhinovski", nr.19-1/6 në Shkup, çdo ditë pune prej orës 09 deri në orën 17. Informohuni ose caktoni takim në tel. (02) 3224198

*Kjo fletushkë është realizuar me mbështetjen e **Bashkimit Evropian**. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Shoqatës Konekt dhe e autorëve të përmbajtjeve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i përfaqëson qëndrimet e **Bashkimit Evropian**.*